

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË SHKODËR**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Shkodër me objekt: “Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimi i fondeve publike, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, funksionimi i INU-së, administrimin e aseteve, vlerësimin për shitje të trojeve nën objekt, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë bashkiake, vlerësimi i auditit të brendshëm, etj” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 82, datë 6.6.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 143/7, datë 6.6.2012, dërguar **z. Lorenc LUKA**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

1. Në zbatim të pikës 9 e 11 të VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publik”, të gjithë punonjësvë, paga mujore e të cilëve është më e vogël se paga mujore e kategorisë II-b të Drejtorëve të Drejtorive në Ministri, t’ju hiqet përballimi nga buxheti të shpenzimeve të telefonisë së lëvizshme.

**Menjëherë**

2. Të bëhet ndryshimi dhe miratimi i strukturës organike të administratës në këto drejtori: Drejtoria Promovim Zhvillimit, Marrëdhënieve me Publikun dhe Saktësimin e Adresave; Drejtoria Administrimit, Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse; Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit; Drejtoria e të Ardhurave; Drejtoria e Auditit dhe Drejtoria e Inspektimit të Ndërtimit, sipas kërkesave të VKM nr. 693, datë 18.8.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 1619, datë 02.7.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësvë të organeve të qeverisjes vendore”, i ndryshuar, lidhja nr. 4 “Klasifikimi i vendeve të punës në shërbimin civil për organet e qeverisjes vendore”, si dhe të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”.

**Menjëherë**

3. Në mbështetje të diplomave që disponojnë punonjësit e institucioneve në varësi të bashkisë, t’ju bëhet rregullimi i pagave në pozicion, sipas kërkesave të VKM nr. 693, datë 18.8.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 1619, datë 02.7.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësvë të organeve të qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

**Menjëherë**

4. Të bëhet vlerësimi vjetor individual i punës për çdo punonjës, kërkesë kjo e UKM nr. 2, datë 7.7.2000 “Për sistemin e vlerësimit të arritjeve vjetore individuale të nëpunësit civil”.

**Çdo vit**

5. Inspektorati Ndërtimor Urbanistik të marrë masat për gjitha rastet kur subjektet ndërtuese nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore në fushën e ndërtimit dhe të planifikimit të territorit që:

-Të vendos gjoba sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e ndërtimit dhe të planifikimit të territorit;

- Të paraqesë pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje licence profesionale personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit pa leje, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të punimeve të ndërtimit;
- Të vendosë prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm;
- Të përgatisë kallëzimin penal gjatë ushtrimit të kontrollit, që ti paraqesë ato pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi.

**Vazhdimisht**

**6.** Kryeinspektori INU-së në bashkëpunim me Sektorin e Financës të kërkojë arkëtimin e gjobave të vendosura, për të gjithë investitorët ndërtimor. Kryeinspektori INU-së të pezullojë punimet e ndërtimit për të gjithë rastet, deri në pagesën e plotë të tyre.

**Vazhdimisht**

**7.** Të merren masa në lidhje me kualifikimin e punonjësve të Policisë bashkiake, për të kaluar formimin e tyre në Akademinë e Rendit në zbatim të Rregullores 823, datë 11.4.2003.

**Vazhdimisht**

**8.** Të hartohen programet e punës i ndarë ky në programe tre mujorë dhe mujore, në zbatim të neneve 8 e 35 të rregullores 823, datë 11.4.2003.

**Vazhdimisht**

**9.** Policia bashkiake në bashkëpunim me Sektorin e Financës të kërkojë arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia bashkiake.

**Vazhdimisht**

**10.** Kryeinspektori i Policisë bashkiake në veprimtarinë e tij dhe të sektorit që ai drejton, duhet të zbatojë detyrat e ngarkuara nga titullari në zbatim të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997, i ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.4.1998 dhe rregulloren nr. 823, datë 11.4.2003.

**Vazhdimisht**

**11.** Dokumentacioni shkresor dhe ligjor i Policisë bashkiake të mbahet sipas dispozitave ligjore për arkivat dhe për lëvizjen e letrave me vlerë

**Vazhdimisht**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Të kërkohen në rrugë ligjore dëmet ekonomike në vlerën totale **8,610,296 lekë**, të shkaktuara buxhetit të shtetit nga ku:

**B. 1. Vlera 119,927 lekë**, në ngarkim të 3 punonjësve për dhënie page në kundërshtim me VKM nr. 693, datë 18.8.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 1619, datë 02.7.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, i ndryshuar, lidhja nr. 7 “Vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar”, lidhja nr. 2 “Nivelet e pagave për nëpunësit civil në bashkitë e tjera, njësitë bashkiake të Tiranës dhe nëpunësit e komunave”.

**Deri në arkëtimin e plotë**

**B. 2. Vlera 268,028 lekë (pa t.v.sh.)**, në ngarkim të 3 operatorëve ekonomikë, pasi nga kontrolli i dokumentacionit teknik të zbatimit i administruar në dosjen teknike dhe nga matjet në vend, u konstatuan diferenca në zëra e volume të pakryera në fakt.

Operatorët ekonomikë janë:

1. [REDAKTUAR], për vlerën **70,800 lekë**, për objektin “Rikonstruktion Rruga Besëlidhja;
2. [REDAKTUAR] për vlerën **72,428 lekë**, për objektin “Ndërtim i varrezave publike” dhe

3. ██████ për vlerën **124,800 lekë**, për objektin “Sistemim oborri dhe terrene sportive shkolla 9 vjeçare Mati Logoreci”

**Deri në arkëtimin e plotë**

**B.3, Vlera 8,186,841 lekë**, në ngarkim të 24 subjekteve, kjo si rezultat i llogaritjes gabim të vlerës së “Taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja”.

**Deri në arkëtimin e plotë**

**B.4. Vlera 35,500 lekë** në ngarkim të 7 subjekteve, kjo si rezultat i mos pagesës së tarifës të përcaktuar për aktet e kontrollit të punimeve dhe të lejes të shfrytëzimit.

**Deri në arkëtimin e plotë**

### **C. MASA ADMINISTRATIVE.**

**C. I** Në mbështetje të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, Kreu III-të “Sanksionet” nenet 15 e 16 dhe ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, Bashkia Shkodër të kërkojë nga Kryeinspektori i Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik pranë Bashkisë, të gjobisë mbikëqyrësit dhe kolaudatorët e punimeve të ndërtimit, sepse: Veprimet e kryera prej tyre bien në kundërshtim me nenin 4, paragrafi parë, Kreu II-të, neni 7 paragrafi tretë, neni 8 paragrafi dytë, neni 9 paragrafi tretë shkronja “c” dhe neni 12 paragrafi parë pikat 1,2,3 dhe 4 të Kreut III-të, të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Mbi kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; me piken 4 paragrafi tretë, pika 5/c dhe 15 paragrafi i dytë, pika 17 dhe 19 të Kreut I-rë, pikat 3/a, 3/b dhe 3/c të Kreut II-të të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” dhe pikat 3/4, 7, 7/1 dhe 7/3 Kreu I-rë dhe pikat 2, 2/1 dhe 4 të Kreut III-të të udhëzimit KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

#### **Mbikëqyrësit dhe kolaudatorët e punimeve të ndërtimit janë:**

**a.** ██████ në cilësinë e mbikëqyrëses të punimeve në objektin “Rikonstruksion Rruga Besëlidhja” dhe në cilësinë e kolaudatores në objektin “Ndërtim i varrezave publike”, **gjobë në masën 500,000 lekë**, për dëmin ekonomik në vlerën 145,228 lekë sepse:

Nga kontrolli dhe shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, në projekt zbatim, preventiv oferte me ndryshimet e pasqyruara, libër masash, kontroll fizik në vend për realizimin në fakt të vëllimeve të punës së kryer dhe krahasimi i tyre me situacionin përfundimtar për pagesë u konstatuan diferenca në plus dhe përfitime më tepër në zërat e punimeve, në vlerën totale **145,228 lekë**.

**b.** ██████ në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin “Sistemim oborri dhe terrene sportive shkolla 9 vjeçare Mati Logoreci” dhe në cilësinë e kolaudatorit në objektin “Rikonstruksion Rruga Besëlidhja”, **gjobë në masën 500,000 lekë**, për dëmin ekonomik në vlerën 195,600 lekë sepse:

Nga kontrolli dhe shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, në projekt zbatim, preventiv oferte me ndryshimet e pasqyruara, libër masash, kontroll fizik në vend për realizimin në fakt të vëllimeve të punës së kryer dhe krahasimi i tyre me situacionin përfundimtar për pagesë u konstatuan diferenca në plus dhe përfitime më tepër në zërat e punimeve, në vlerën totale **195,600 lekë**.

**c.** ██████ në cilësinë e mbikëqyrëses të punimeve në objektin “Ndërtim i varrezave publike”, **gjobë në masën 50,000 lekë**, për dëmin ekonomik në vlerën 74,428 lekë sepse:

Nga kontrolli dhe shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, në projekt zbatim, preventiv oferte me ndryshimet e pasqyruara, libër masash, kontroll fizik në vend për realizimin në fakt të vëllimeve të punës së kryer dhe krahasimi i tyre me situacionin

përfundimtar për pagesë u konstatuan diferenca në plus dhe përfitime më tepër në zërat e punimeve, në vlerën totale **74,428 lekë**.

**d.** ■■■ në cilësinë e kolaudatorit të punimeve në objektin “Sistemim oborri dhe terrene sportive shkolla 9 vjeçare Mati Logoreci”, **gjobë në masën 500,000 lekë**, për dëmin ekonomik në vlerën 124,800 lekë sepse:

Nga kontrolli dhe shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, në projekt zbatim, preventiv oferte me ndryshimet e pasqyruara, libër masash, kontroll fizik në vend për realizimin në fakt të vëllimeve të punës së kryer dhe krahasimi i tyre me situacionin përfundimtar për pagesë u konstatuan diferenca në plus dhe përfitime më tepër në zërat e punimeve, në vlerën totale **124,800 lekë**.

#### **D. MASA DISIPLINORE.**

**D.1.** Mbështetur në nenin 13, shkronja “i” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në Kreun X-të, pika 3 të VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në Kreun VIII-të “Masat Disiplinore”, neni 25, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i Nëpunësit Civil", i ndryshuar, në pikat 1 e 2 të VKM nr.306, datë 13.06.2000 "Për Disiplinën në Shërbimin Civil", i kërkojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, dhënien e masave disiplinore, si më poshtë:

##### **“Vërejtje me Paralajmërim”, neni 25, pika 3, shkronja ”b”**

**1. Për z. ■■■** me detyrë Drejtor i Drejtorisë të Shërbimeve Publike dhe me cilësinë e Kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, sepse:

-Në 5 prokurime të vitit 2011 me fond limit 78,007 mijë lekë (me TVSH)

ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorët ekonomikë në kundërshtim me pikat 3.7 e 3.12 të pikës 3 “Udhëzime për Operatorët Ekonomikë”, me pikat 4.9 e 4.10 të pikës 4 “Pjesmarrja dhe Kualifikimi”, me pikat 5.7, 5.8 e 5.9 të pikës 5 “Vlerësimi i Ofertave” të Dokumentëve Standartë të Tenderit (DT), me Kreun VII-të, pika 2 shkronja ”b” të VKM nr.1, datë 10.01.2007, me nenin 56 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 e me Kreun V-të, pika 4 shkronja ”ë” të VKM nr.1, datë 10.01.2007.

**2. Për z. ■■■** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve Publike dhe me cilësinë e Kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, sepse:

-Në 8 prokurime të vitit 2011 me fond limit 80,094 mijë lekë (me TVSH).

ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorët ekonomikë në kundërshtim me pikat 3.7 e 3.12 të pikës 3 “Udhëzime për Operatorët Ekonomikë”, me pikat 4.9 e 4.10 të pikës 4 “Pjesmarrja dhe Kualifikimi”, me pikat 5.7, 5.8 e 5.9 të pikës 5 “Vlerësimi i Ofertave” të Dokumentëve Standartë të Tenderit (DT), me Kreun VII-të, pika 2 shkronja ”b” të VKM nr.1, datë 10.01.2007, me nenin 47 e 56 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe me Kreun V-të, pika 4 shkronja ”ë” të VKM nr.1, datë 10.01.2007.

**3. Për z. ■■■** me detyrë Përgjegjës i zyrës së arsimit e konvikteve dhe me cilësinë e Kryetarit dhe anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave dhe anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave sepse:

-Në 7 prokurime të vitit 2011 me fond limit 24,166 mijë lekë (me TVSH)

ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorët ekonomikë në kundërshtim me pikat 3.7 e 3.12 (për 1 tender) të pikës 3 “Udhëzime për Operatorët Ekonomikë”, me pikat 4.9 e 4.10 (për 1 tender) të pikës 4 “Pjesmarrja dhe Kualifikimi”, me pikat 5.7, 5.8 e 5.9 të pikës 5 “Vlerësimi i Ofertave” të Dokumentëve Standartë të Tenderit (DT), me Kreun VII-të, pika 2 shkronja ”b” të VKM nr.1, datë 10.01.2007, me nenin 56 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe me Kreun V-të, pika 4 shkronja ”ë” të VKM nr.1, datë 10.01.2007.

**4. Për zj. ■■■** me detyrë Specialiste në Drejtorinë Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve dhe me cilësinë e anëtares të komisionit të vlerësimit të ofertave dhe

**5. Për z. ■** me detyrë Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe me cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave sepse:

-Në 17 prokurime të vitit 2011 me fond limit 189,860 mijë lekë(me TVSH) ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorët ekonomikë në kundërshtim me pikat 3.7 e 3.12 të pikës 3 "Udhëzime për Operatorët Ekonomikë", me pikat 4.9 e 4.10 të pikës 4 "Pjesmarrja dhe Kualifikimi", me pikat 5.7, 5.8 e 5.9 të pikës 5 "Vlerësimi i Ofertave" të Dokumentëve Standartë të Tenderit (DT), me Kreun VII-të, pika 2 shkronja "b" të VKM nr.1, datë 10.01.2007, me nenin 56 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe me Kreun V-të, pika 4 shkronja "ë" të VKM nr.1, datë 10.01.2007.

**6. Për zj. ■** me detyrë Specialiste në zyrën e arsimit e konvikteve dhe me cilësinë e anëtares të komisionit të vlerësimit të ofertave dhe të komisionit për prokurimet me vlera të vogla (për zyrën e arsimit) sepse:

-Me cilësinë e anëtares së prokurimeve me vlera të vogla, në 14 raste të këtyre prokurimeve me vlerë 2,443,359 lekë ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.1, date 10.01.2007, Kreu IV-të, pika 2, shkronjat "b" dhe "c", si dhe të UAPP nr.2, date 18.02.2008, pika 5.

-Me cilësinë e anëtares të komisionit të vlerësimit të ofertave, në 4 prokurime të vitit 2011 me fond limit 14,433 mijë lekë(me TVSH),ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorët ekonomikë në kundërshtim me pikat 3.7 të pikës 3 "Udhëzime për Operatorët Ekonomikë", me pikat 5.7, 5.8 e 5.9 të pikës 5 "Vlerësimi i Ofertave" të Dokumentëve Standarte të Tenderit (DT), me Kreun VII-të, pika 2 shkronja "b" të VKM nr.1, datë 10.01.2007, me nenin 56 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe me Kreun V-të, pika 4 shkronja "ë" të VKM nr.1, datë 10.01.2007.

**7. Për zj. ■** me detyrë P/Sektorit në Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Arsimit, Kulturës, Sporteve, Rinisë dhe Gruas dhe me cilësinë e anëtares të komisionit të vlerësimit të ofertave sepse:

-Në 4 prokurime të vitit 2011 me fond limit 14,433 mijë lekë(me TVSH),ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorët ekonomikë në kundërshtim me pikat 3.7 të pikës 3 "Udhëzime për Operatorët Ekonomikë", me pikat 5.7, 5.8 e 5.9 të pikës 5 "Vlerësimi i Ofertave" të Dokumentëve Standarte të Tenderit (DT), me Kreun VII-të, pika 2 shkronja "b" të VKM nr.1, datë 10.01.2007, me nenin 56 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe me Kreun V-të, pika 4 shkronja "ë" të VKM nr.1, datë 10.01.2007.

**8. Për zj. ■** me detyrë P/Sektorit në Drejtorinë Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve dhe me cilësinë e anëtares të njesisë të prokurimit në 9 prokurime të zhvilluara në vitin 2011;

**9. Për z. ■** me detyrë Specialiste në Drejtorinë Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve dhe me cilësinë e anëtares të njesisë të prokurimit në 23 prokurime të zhvilluara në vitin 2011;

**10. Për z. ■** me detyrë Specialist në Drejtorinë Juridike, Prokurimeve dhe Aseteve dhe me cilësinë e anëtarit të njesisë të prokurimit në 14 prokurime të zhvilluara në vitin 2011 dhe

**11. Për z. ■** me detyrë Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe me cilësinë e anëtarit të njesisë të prokurimit në 19 prokurime të zhvilluara në vitin 2011, sepse:

-Mungon deklaratat që nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, në kundërshtim me Kreun V-të, pika 1 shkronja "a" të VKM nr.1, datë 10.01.2007; procesverbali për miratimin e DT, nuk është hartuar plotësisht siç përcaktohet në Kreun V-të, pika 2 shkronja "a" të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kjo për faktin e mos trajtimit të hartimit të specifikimeve teknike; në kriteret e veçanta të kualifikimit, pjesa Kapaciteti teknik "Licenca profesionale e shoqërisë", ka mos përputhje në mes kërkesave për kategoritë e kërkuara të licencës me zërat e punimeve që janë në preventiv, mungon Leja e ndërtimit për të gjithë prokurimet e punëve publike dhe arkivimi i dosjeve nuk është bërë në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat".

**D.2.**Mbështetur në Kreun VIII-të “Masat Disiplinore”, neni 25, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i Nëpunësit Civil", i ndryshuar , në pikat 1 e 2 të VKM nr.306, datë 13.06.2000 "Për Disiplinën në Shërbimin Civil", i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë, dhënien e masave disiplinore, si më poshtë:

**“Vërejtje me Paralajmërim”, neni 25, pika 3, shkronja ”b”**

**1. Për zj.** ■ me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ekonomike, sepse;

-Gjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2011, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 ”Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, nuk ka paraqitur çdo 4 muaj në Këshillin Bashkiak Raportet e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për Performancën Financiare, Produktet dhe Objektivat e Realizuara për çdo Program të Përcaktuar.

-Në kundërshtim me pikën 9 e 11 të VKM nr.864, datë 23.7.2010 ”Për paisjen me numer telefoni celulare te personave juridikë publikë”, ka paraqitur relacion dhe ka firmosur P/Vendimin i kthyer në Vendim nga Këshilli i Bashkisë, për përballimin nga shpenzimet operative të vlerës 4,000 lekë në muaj për 14 punonjësit e këtij institucioni.

-Në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.693, datë 16.8.2010, lidhja nr.4 dhe ligjit nr.9870, datë 16.7.2007 ”Për Inspektoriatin e Ndërtimit”, ka paraqitur relacion dhe ka firmosur një P/Vendimin i kthyer në Vendim nga Këshilli i Bashkisë, për strukturën organizative për 4 Drejtori të Përgjithshme dhe 2 Drejtori.

**2. Për z.** ■ me detyrë Drejtor i Drejtorisë Administrimit, Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe me cilësinë e Kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave, sepse:

-Në kundërshtim me pikën 9 e 11 të VKM nr.864, datë 23.7.2010 ”Për paisjen me numër telefoni celulare të personave juridikë publikë”, ka paraqitur relacion dhe ka firmosur P/Vendimin i kthyer në Vendim nga Këshilli i Bashkisë, për përballimin nga shpenzimet operative të vlerës 4,000 lekë në muaj për 14 punonjësit e këtij institucioni.

-Në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.693, datë 16.8.2010, lidhja nr.4 dhe ligjit nr.9870, datë 16.7.2007 ”Për Inspektoriatin e Ndërtimit”, ka paraqitur relacion dhe ka firmosur P/Vendimin i kthyer në Vendim nga Këshilli i Bashkisë, për strukturën organizative për 4 Drejtori të Përgjithshme dhe 2 Drejtori.

-Në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave në 2 prokurime të vitit 2011 me fond limit 10,821 mijë lekë(me TVSH), ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorët ekonomikë në kundërshtim me pikat 3.7 të pikës 3 ”Udhëzime për Operatorët Ekonomikë”, me pikat 5.7, 5.8 e 5.9 të pikës 5 ”Vlerësimi i Ofertave” të Dokumentëve Standarte të Tenderit (DT), me Kreun VII-të, pika 2 shkronja ”b” të VKM nr.1, datë 10.01.2007, me nenin 56 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe me Kreun V-të, pika 4 shkronja ”e” të VKM nr.1, datë 10.01.2007, të gjitha këto të trajtuara në procesverbalin nr.6, datë 28.3.2012.

**D.3.**Mbështetur në nenin 13, shkronja “i” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në Kreun X-të, pika 3 të VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në Kreun VIII-të “Masat Disiplinore”, neni 25, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i Nëpunësit Civil", i ndryshuar , në pikat 1 e 2 të VKM nr.306, datë 13.06.2000 "Për Disiplinën në Shërbimin Civil", i kërkojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, dhënien e masave disiplinore, si më poshtë:

**“Vërejtje me shkrim”, neni 25, pika 3, shkronja ”a”**

**1. Për zj.** ■ me detyrë P/ sektorit të financës në Drejtorinë Ekonomike dhe me cilësinë e Kryetares të komisionit të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla për bashkinë, sepse:

-Me cilësinë e kryetares së prokurimeve me vlera të vogla, në 17 raste të këtyre prokurimeve me vlerë 2,666,317 lekë ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.1, date 10.01.2007, Kreu IV-të, pika 2, shkronjat ”b” dhe ”c”, si dhe të UAPP nr.2, date 18.02.2008, pika 5.

**2. Për zj. ■■■** me detyrë P/sektoir të personelit dhe informatizimit në Drejtorinë e Administrimit, Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe me cilësinë e anëtares të komisionit të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, për bashkinë, sepse:

-Me cilësinë e anëtares së prokurimeve me vlera të vogla, në 17 raste të këtyre prokurimeve me vlerë 2,666,317 lekë ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.1, date 10.01.2007, Kreu IV-të, pika 2, shkronjat "b" dhe "c", si dhe të UAPP nr.2, date 18.02.2008, pika 5.

**3. Për z. ■■■** me detyrë Specialist në sektorin e personelit dhe informatizimit në Drejtorinë e Administrimit, Personelit dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe me cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, për bashkinë, sepse:

-Me cilësinë e anëtarit të prokurimeve me vlera të vogla, në 17 raste të këtyre prokurimeve me vlerë 2,666,317 lekë ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.1, date 10.01.2007, Kreu IV-të, pika 2, shkronjat "b" dhe "c", si dhe të UAPP nr.2, date 18.02.2008, pika 5.

**4. Për zj. ■■■** me detyrë Specialiste e financës në zyrën e arsimit e konvikteve dhe me cilësinë e kryetares së komisionit të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, për zyrën e arsimit, sepse:

-Me cilësinë e kryetares së prokurimeve me vlera të vogla, në 14 raste të këtyre prokurimeve me vlerë 2,443,359 lekë ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.1, date 10.01.2007, Kreu IV-të, pika 2, shkronjat "b" dhe "c", si dhe të UAPP nr.2, date 18.02.2008, pika 5.

**5. Për zj. ■■■** me detyrë Specialiste në zyrën e arsimit e konvikteve dhe me cilësinë e anëtares të komisionit të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, për zyrën e arsimit, sepse:

-Me cilësinë e anëtares së prokurimeve me vlera të vogla, në 14 raste të këtyre prokurimeve me vlerë 2,443,359 lekë ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.1, date 10.01.2007, Kreu IV-të, pika 2, shkronjat "b" dhe "c", si dhe të UAPP nr.2, date 18.02.2008, pika 5.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Fatos Gjyzezi, Ramadan Zejnuni, Agim Mandri dhe Xhemal Luka. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

## KONTROLI I LARTË I SHTETIT